



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 31, datë 18.07.2017

MBI TARIKAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË UK
DURRËS SHA

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, vendimit nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" dhe vendimit nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë UK Durrës Sha :

a. Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizim me ujë	Largimi dhe përpunimi ujërave tëndotura
Konsumator familjar	70 lekë/m ³	50 lekë/m ³
Konsumator publik	120 lekë/m ³	60 lekë/m ³
Konsumator privat	130 lekë/m ³	60 lekë/m ³

b. Tarifë fikse

Konsumator familjar	150 lekë/muaj/klient
Konsumator publik	150 lekë/muaj/klient
Konsumator privat	150 lekë/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin e plotë kalendarik, pas aplikimit të tarifave të reja:

➤ uji pa të ardhura (humbjet)	68.3 %
➤ niveli i matjes	88.9 %
➤ kohëzgjatja e furnizimi	7.4 orë/ditë
➤ efiçenca e stafit	4.87p/000/lidhje
➤ mbulimi me ujë	82.1 %
➤ mbulimi me kanalizime	47.6%
➤ norma e arkëtimit	80 %
➤ cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standardeve

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK Durrës Sha do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr.10, datë 10.02.2016 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për U K Durrës Sha " shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 01.09.2017 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETAR

NDRIÇIM SHANI